

## **GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**

**Api-Kz nr. 2/2012**

**24 shtator 2012**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë prej Gjyqtarit të EULEX-it Tore Thomassen si kryetar i kolegjit, Gjyqtarëve Elka Filcheva-Ermenkova, Nesrin Lushta, Cornelie Peeck dhe Avdi Dinaj si anëtarë të kolegjit, në prani të Chiara Rojek, Zyrtare ligjore duke vepruar në cilësi të procesmbajtëses.

Në procedurën penale kundër të pandehurve

**B.H.**, i njohur si , i lindur më , shtetas i Kosovës, vendbanimi i fundit në fshatin , emri i babait , emri i nënës , , në paraburgim prej 21 janarit 2008.

Dhe **S.Q.**, emri i babait , mbiemri i vajzërisë së nënës , i lindur më , shtetas i Kosovës, vendbanimi i fundit në fshatin , , në paraburgim prej 21 janarit 2008.

Të shpallur fajtorë në shkallën e parë me aktgjykimin P nr. 459/2007 e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë të datës 7 shkurt 2011 për veprat penale Vrasje të rëndë në bashkëkryerje sipas nenit 147 pikave 3 dhe 11 në lidhje me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së), Vrasje të rëndë në tentativë në bashkëkryerje sipas nenit 147 pikave 3 dhe 11 në lidhje me nenet 20 dhe 23 të KPK-së dhe Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim të nenit 328 paragrafit 2 të KPK-së dhe të dënuar me dënim unik prej tridhjetëtre (33) vite burgim afatgjatë për secilin.

Të konfirmuar në shkallën e dytë me aktgjykimin Ap-Kz nr. 264/2011 të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 12 tetor 2011.

Dhe **N.C.**, emri i babait , mbiemri i vajzërisë së nënës , i lindur më , shtetas i Kosovës, me vendbanim në fshatin ,

I liruar në shkallën e parë me anë të aktgjykimit të njëjtë për veprat penale Vrasje të rëndë në bashkëkryerje sipas nenit 147 pikave 3, 8 dhe 9 në lidhje me nenin 23 të KPK-së dhe Vrasje të rëndë në tentativë në bashkëkryerje sipas nenit 147 pikës 3 në lidhje me nenet 20 dhe 23 të KPK-së.

Të konfirmuar në shkallën e dytë ma anë të aktgjykimit të njëjtë të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 12 tetor 2011.

Duke vendosur lidhur me ankesat e paraqitura më 1 dhjetor 2011 nga avokati mbrojtës Tahir Rrecaj në emër të pandehurit B.H., më 7 dhjetor 2011 nga avokati mbrojtës Avni Ibrahimini në emër të pandehurit S.Q. dhe më 7 dhjetor 2011 nga Prokurori Special i Republikës së Kosovës (PSRK) kundër aktgjykimit Ap-Kz nr. 264/2011 të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 12 tetor 2011, dhe duke pasur parasysh përgjigjet ndaj ankesave të paraqitura më 28 dhjetor 2011 nga avokati mbrojtës Azem Vllasi në emër të N.C. dhe më 20 shkurt 2012 nga avokati mbrojtës Mahmut Halimi në emër të pandehurit B.H. dhe mendimin dhe propozimin nga Zyra e Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPShK-së) të paraqitur më 16 mars 2012.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Api-Kži nr. 2/2012

24 shtator 2012

Pas mbajtjes së dy seancave publike më 18 dhe 21 shtator 2012 në prani të pandehurit B.H. dhe avokatit të tij mbrojtës Tahir Rrecaj, pandehurit S.Q. dhe avokatit të tij mbrojtës Avni Ibrahimi, avokatit mbrojtës Azem Vllasi duke përfaqësuar N.C., Prokurorit Jusuf Mezini duke përfaqësuar Zyrën e Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPShK) dhe palëve të dëmtuara M.B., H.B., I.B., B.B dhe S.B., dhe pas këshillimit dhe votimit më 24 shtator 2012.

Sipas neneve 420 dhe në vijim të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-së), lëshon këtë:

### AKTGJYKIM

1. Ankesa e paraqitur nga PSRK-ja kundër aktgjykimit Ap-Kz nr. 264/2011 të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 12 tetor 2011 në lidhje me lirimin e N.C., **HEDHET POSHTË** si e palejueshme.
2. Ankesa e paraqitur nga PSRK-ja kundër aktgjykimit Ap-Kz nr. 264/2011 të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 12 tetor 2011 në lidhje me dënimin e të pandehurve B.H. dhe S.Q., **REFUZOHET** si e pabazuar.
3. Ankesat e paraqitura në emër të pandehurit B.H. dhe në emër të pandehurit S.Q. kundër aktgjykimit Ap-Kz nr. 264/2011 të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 12 tetor 2011, **REFUZOHEN** si të pabazuara.
4. Aktgjyki Ap-Kz nr. 264/2011 i Gjykatës Supreme të Kosovës i datës 12 tetor 2011 dhe aktgjyki P nr. 459/2009 i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë i datës 7 shkurt 2011 në lidhje me të pandehurit B.H. dhe S.Q., **VËRTETOHEN**.

### ARSYETIM

#### I. Historia e procedurës

1. Më 02 nëntor 2009, Prokurori Special ka ngritur aktakuzën PPS nr. 41/09 pranë Gjykatës së Qarkut në Prishtinë duke akuzuar të pandehurit B.H., S.Q., N.C. (dhe të pandehur të tjerë) për një pikë të Vrasjes së rëndë në kundërshtim të nenit 147 paragrafit 1 pikave 3, 8 dhe 9 në lidhje me nenin 23 të KPK-së, dy pika të Vrasjes së rëndë në kundërshtim të nenit 147 paragrafit 1 pikës 3 në lidhje me nenin 23 të KPK-së, dy pika të Vrasjes së rëndë në tentativë në kundërshtim të nenit 147 paragrafit 1 pikës 3 në lidhje me nenet 20 dhe 23 të KPK-së. B.H. dhe S.Q. përveç kësaj janë akuzuar edhe për veprën penale Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim të nenit 328 paragrafit 2 të KPK-së.

2. Më 19 janar 2010, aktakuza është konfirmuar me anë të aktvendimit KA nr. 414/2009 për akuzat e Vrasjes së rëndë të N.B., Vrasjes së rëndë të U.B. dhe S.B. kundër B.H., S.Q. dhe N.C., dhe për Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve kundër B.H. dhe S.Q. Aktakuza është hedhur poshtë në pjesët e saj të mbeturë.

3. Shqyrtimi gjyqësor ka filluar në qershor 2010 deri në shkurt 2011. Më 07 shkurt 2011, Gjykata e Qarkut në Prishtinë ka shpallur B.H. dhe S.Q. fajtorë për veprat penale Vrasje e rëndë në bashkëkryerje në kundërshtim të nenit 147 paragrafit 1 pikave 3 dhe 11 në lidhje me

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Api-Kži nr. 2/2012

24 shtator 2012

nenin 23 të KPK-së (pika a),<sup>1</sup> Vrasje të rëndë në tentativë në bashkëkryerje në kundërshtim të nenit 147 paragrafit 1 pikave 3 dhe 11 në lidhje me nenet 20 dhe 23 të KPK-së (pika b)<sup>2</sup> dhe Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim të nenit 328 paragrafit 2 të KPK-së (pika c).

4. Të pandehurit janë dënuar me tridhjetetre (33) vjet burgim afatgjatë për pikën (a), dhjetë (10) vjet burgim për pikën (b) dhe dy (2) vjet burgim për pikën (c).<sup>3</sup> Gjykata e Qarkut ka shqiptuar një dënim unik prej tridhjetetre (33) vite burgim afatgjatë kundër secilit të pandehur. Ata gjithashtu janë dënuar edhe me pagesën në mënyrë kumulative dhe të përbashkët të shumës prej 25.000 Euro për secilën palë të dëmtuar. N.C. është liruar sipas nenit 390 pikës 3 të KPPK-së, sepse nuk është provuar se ai ka kryer veprat penale për të cilat është akuzuar.<sup>4</sup>

5. Në maj dhe qershor 2011, avokati mbrojtës i B.H., avokati mbrojtës Avni Ibrahimini për S.Q. dhe Prokurori Special kanë paraqitur ankesa kundër aktgjykimit të shkallës së parë P nr. 459/2009. Më 12 tetor 2011, Gjykata Supreme e Kosovës duke vepruar si shkallë e dytë ka lëshuar aktgjykimin Ap-Kz nr. 264/2011 me të cilin të gjitha ankesat janë refuzuar si të pabazuara dhe aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar.<sup>5</sup>

6. Kundër aktgjykimit të shkallës së dytë, avokati mbrojtës Tahir Recaj ka paraqitur ankesë në emër të B.H.t më 1 dhjetor 2011, dhe avokati mbrojtës Avni Ibrahimini ka paraqitur

<sup>1</sup> “sepse në mes të orës 00.10-00.15 të natës në mes të 27 dhe 28 shtatorit 2007 ata kanë vrarë N.B, U.B. dhe S.B. në mënyrë dinake te Ura e Lepencit (e cila gjendet në rrugën nga Prishtina për në Shkup e cila shpie në fshatin Soponicë). Në veçanti, të pandehurit ia kanë zënë pritën veturës Golf 2 me targa 469KS117, në të cilën N.B, U.B. dhe S.B (së bashku me B.B. dhe S.B.) ishin duke udhëtuar në drejtim të fshatit Dubravë. Kur vetura ka arritur te Ura e Lepencit, B.H. dhe S.Q. (të cilët ishin duke pritur në anën e djathë të rrugës) kanë hapur zjarr mbi veturën me dy pushkë automatike AK 47. N.B. është qëlluar me shumë plumbë në pjesën e djathë të trupit dhe një plumb e ka qëlluar në pjesën e djathë të kokës, duke hyrë në tru dhe duke ia shkaktuar vdekjen. U.B. ka vdekur si pasojë e dëmeve të shkaktuara nga plumbat në zemër, mushkëri dhe mëlçi, dhe S.B. ka vdekur si pasojë e lëndimeve të shkaktuara nga plumbat në pjesën e djathë të kokës.”

<sup>2</sup> “sepse mes të orës 00.10-00.15 të natës në mes të 27 dhe 28 shtatorit 2007 ata kanë tentuar të vrasin B.B. dhe S.B. në mënyrë dinake te Ura e Lepencit (e cila gjendet në rrugën nga Prishtina për në Shkup e cila shpie në fshatin Soponicë). Në veçanti, të pandehurit ia kanë zënë pritën veturës Golf 2 me targa 469KS117, në të cilën B.B. dhe S.B. ishin duke udhëtuar në drejtim të fshatit Dubravë. Kur vetura ka arritur te Ura e Lepencit, B.H. dhe S.Q. (të cilët ishin duke pritur në anën e djathë të rrugës) kanë hapur zjarr mbi veturën me dy pushkë automatike AK 47. Së paku 40 plumbë nga AK 47 kalibri 7.62 janë shtenë në veturën e përdorur nga viktimat. B.B. është qëlluar nga plumbat në kokë dhe në anën e djathë të abdomenit, përfshirë indet lëkuore, indet e qelizave, *ascenden e zorrës së trashë*, i cili tani ka depërtuar dhe përbërja e të cilët është shpërndarë në abdomen dhe pjesërisht ka dëmtuar *omentum majus*. Përkundër lëndimeve të rënda, B.B. ka mbijetuar. S.B. drejtëpërdrejtë ka qenë i ekspozuar ndaj rafalit të plumbave të cilët kanë shkaktuar vdekjen dhe lëndimet e viktimate të tjera, mirëpo për mrekulli ka mbetur i pa lënduar.”

<sup>3</sup> “sepse në rrethanat e pëershkuara më lart nën pikat 1 dhe 2, ata pa autorizim kanë transportuar , kanë pasur në posedim dhe kanë përdorur dy pushkë automatike të modelit Kallahnikov AK 47 të kalibrit 7.62, me të cilat kanë kryer veprat penale të pëershkuara më lart nën pikat a. dhe b.”

<sup>4</sup> Një i bashkëpandehur tjetër është shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim të nenit 328 paragrafit 2 të KPK-së dhe është dënuar me gjobë.

<sup>5</sup> Më 14 shkurt 2012, Gjykata Supreme e Kosovës ka lëshuar aktvendimin Ap-Kz nr. 264/2011 mbi korrigjin e gabimeve të shtypit të përbajtura në aktgjykimin Ap-Kz nr. 264/2011.

## **GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**

**Api-Kži nr. 2/2012**

**24 shtator 2012**

ankesë në emër të S.Q. më 7 dhjetor 2011. Gjithashtu, Prokurori Special ka paraqitur ankesë më 7 dhjetor 2011. Avokati mbrojtës Mahmut Halimi duke përfaqësuar B.H. dhe avokati mbrojtës Azem Vllasi, së bashku me N.C. kanë paraqitur përgjigje ndaj ankesave më 28 dhjetor 2011. ZPSHk-ja ka paraqitur mendimin dhe propozimin në ankesa më 13 mars 2012.

### **II. Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës**

#### **A. Kompetencat e Gjykatës Supreme të Kosovës**

7. Gjykata Supreme e Kosovës ka kompetenca për të vendosur lidhur me ankesat sipas neneve 26 paragrafit 1 dhe 398 dhe në vijim të KPPK-së. Kolegji i Gjykatës Supreme është formuar në pajtim me Ligjin nr. 03/L-53 mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë dhe Udhëzimit mbi caktimin e lëndëve për gjyqtarët e EULEX-it në lëndë penale në Gjykatën Supreme të Kosovës. Seancat publike janë mbajtur më 18 dhe 21 shtator 2012. Aktgjykimi është shpallur në seancë të hapur më 24shtator.

#### **B. Pranueshmëria e ankesave, përgjigjeve dhe propozimeve në ankesa**

8. Aktgjykimi i fundit Ap-Kz nr. 264/2011 është shpallur më 12 tetor 2011. I pandehuri B.H. e ka pranuar atë më 25 nëntor 2011. Avokati mbrojtës Tahir Rrecaj nuk e ka vendosur datën në fletë-dërgesë dhe ka paraqitur ankesë më 1 dhjetor 2011. I pandehuri S.Q. e ka pranuar aktgjykimin më 25 nëntor, dhe avokati i tij Avni Ibrahim më 30 nëntor. Ankesa është paraqitur më 7 dhjetor 2011. Prokurori Special ka nënshkruar fletë-dërgesën më 24 nëntor dhe ka paraqitur ankesë më 7 dhjetor 2011. N.C. dhe avokati Azem Vllasi kanë pranuar ankesat më 24 dhe 28 dhjetor 2011, përkatësisht, dhe kanë paraqitur përgjigje më 28 dhjetor 2011. Sa i përket avokatit Mahmut Halimi dhe të pandehurit B.H., ata kanë pranuar ankesën e Prokurorit Special më 15 dhe 16 shkurt 2012. Avokati mbrojtës Mahmut Halimi ka paraqitur përgjigje më 20 shkurt 2012.

9. Kolegji i Gjykatës Supreme gjen se të gjitha ankesat si dhe përgjigjet në ankesa janë paraqitur me kohë dhe nga personat e autorizuar, prandaj janë të pranueshme sipas neneve 398 paragrafit 1 dhe 408 të KPPK-së.

#### **C. Meritat e ankesave**

10. Prokurori Special e bazon ankesën e tij në shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 403 të KPPK-së, shkelje të ligjit penale sipas nenit 404 të KPPK-së, dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike sipas nenit 405 të KPPK-së. Ai kërkon nga Gjykata Supreme e Kosovës që të anulojë të dy aktgjykimet e kundërshtuara dhe ta kthejë lëndën në rigjykim.

11. Mbrojtja e B.H. dhe S.Q. pretendon se gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë kanë bërë shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale, shkelje të ligjit penal dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, më tutje, ata kundërshtojnë vendimin mbi sanksionet penale sipas nenit 406 të KPPK-së. Avokati Tahir

## **GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**

**Api-Kži nr. 2/2012**

**24 shtator 2012**

Rrecaj i propozon Gjykatës Supreme të Kosovës që të anulojë aktgjykimet e kundërshtuara dhe ta kthej lëndën në rigjykim. Avokati mbrojtës Avni Ibrahim i kërkon që të ndryshohet aktgjykimi i shkallës së dytë duke liruar S.Q., ose ta anulojë atë dhe lënda të kthehet në rigjykim.

12. Në përgjigjen e tij ndaj ankesës së paraqitur nga Prokurori Special, avokati mbrojtës Mahmut Halimi për B.H. propozon që ajo të aprovohet, të anulohen të dy aktgjykimet e kontestuara dhe lënda të kthehet në rigjykim. Ai thekson se vërtetimi i gjendjes faktike ka qenë i gabuar dhe se gjykata e shkallës së dytë ka qenë e obliguar që të marr parasysh provat e reja të paraqitura nga Prokuroria. Në përgjigjen e tij, avokati Azem Vllasi dhe N.C. pohojnë se ankesa e PSRK-së është e pabazuar pasi që Prokurori pohon se do të dorëzoj prova të reja. Këto prova përbahen në deklaratat e B.H. dhe S.Q. dhe të afërmve të tyre familjarë, për të cilat pohojnë se janë të papranueshme dhe jo bindëse. Ata gjithashtu pohojnë se aktakuza PP nr. 36/2011 e datës 7 tetor 2011, kundër N.C., A.D. dhe A.D.2 për të njëjtat vepra penale është hedhur poshtë me anë të aktvendimit KA nr. 644/2011, dhe procedura penale është ndërprerë.

13. Prokurori i shtetit duke u pajtuar me parashtresat e Prokurorit Special propozon anulimin e të dy aktgjykimeve të kundërshtuara dhe kthimin e lëndës në rigjykim. Prokurori i Shtetit bazon propozimin e tij si në vijim: dispozitivi i aktgjykimit të shkalës së parë është i pakuptueshëm dhe nuk përmban faktet vendimtare në lidhje me natyrën e dënimive; është kundërthënës në brendinë e tij dhe përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale; gjykata e shkallës së dytë nuk ka vlerësuar argumentet e paraqitura në ankesën e PSRK-së kundër aktgjykimit të shkallës së parë; dhe gjykata e shkallës së dytë ka bërë shkelje të nenit 409 paragrafit 4 të KPPK-së duke injoruar provat e reja të dorëzuara nga Prokurori Special. Prokurori i Shtetit gjithashtu pretendon se është provuar se N.C. ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

### **C.1. Ankesa e Prokurorit Special në lidhje me N.C.**

14. Gjykata Supreme e Kosovës gjen se ankesa e paraqitur nga Prokuroi Special në lidhje me lirimin e N.C. është e palejueshme sipas nenit 422 në lidhje me nenin 403 paragrin 1 të KPPK-së.

15. Në ankesën e tij, Prokurori i PSRK-së thekson se e drejta në ankesë kundër aktgjykimit të shkallës së dytë është e paraparë nën Kapitullin XXXVII të Kodit si një instrument i rregullt juridik. Pretendohet se aktgjykimi me të cilin disa të pandehur janë dënuar me burgim afatgjatë dhe disa të tjerë janë liruar duhet të konsiderohet si ‘aktgjykim i përbashkët’. Rrjedhimisht, nenit 430 parografi 1 i KPPK-së mundëson të drejtën në ankesë gjithashtu edhe kundër pjesës mbi lirimin. Për më tepër, kjo dispozitë nuk e specifikon se ankesë mund të paraqitet vetëm në lidhje me pjesën e dënuese. Në përgjigjen e tij, avokati Azem Vllasi dhe N.C. pohojnë se ankesa e paraqitur nga Prokurori Special është e palejueshme sepse ankesë kundër aktgjykimit të shkallës së dytë mund të paraqitet vetëm sa i përket dënimit. Në mendimi e tij, Prokurori i Shtetit pajtohet me parashtresën e Prokurorit Special. Ai pohon se aktgjykimi i shkallës së parë është një dhe i pandashëm dhe dy të

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Api-Kži nr. 2/2012  
24 shtator 2012

pandehur janë dënuar me burgim afatgjatë, Prokurori Special ka të drejtë të paraqes ankesë kundër tërë aktgjykimit.

16. Kolegji i Gjykatës Supreme gjen se pretendimet e Prokurorit janë pa merita. Neni 430 paragrafi 1 nën-paragradi 1 i KPPK-së përcakton “*Ankesë kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë mund të paraqitet në Gjykatën Supreme të Kosovës në rastin kur: 1) Gjykata e shkallës së dytë shqipton dënim me burgim afatgjatë ose vërtetton aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë me të cilin është shqiptuar dënim i tillë [...]*”. Formulimi i këtij neni nuk lë vend për keqinterpretim. E drejta në ankesë është përcaktuar kundër aktgjykimit mbi shqiptimin e dënimit me burgim afatgjatë. Qëllimi i ligjvënësit ka qenë që t'i jepet e drejta personit të dënuar për ta kundërshtuar vendimin mbi shqiptimin e dënimit me burgim afatgjatë, me përjashtim të rregullit të përgjithshëm se vendimi mund të ankimohet vetëm një herë. Një interpretim tjetër i këtij neni do të shpinte në trajtim të ndryshëm të atyre që janë liruar në lëndën e cila përfshinë disa të pandehur dhe atyre të cilët janë të vetmit të pandehur në lëndë.

17. Ligji nuk e parasheh të drejtën e Prokurorit për të kundërshtuar vendimin e gjykatës së shkallës së dytë kur i pandehuri është liruar në të dy shkallët. Në lëndën në fjalë, N.C. është liruar me aktgjykimin e shkallës së parë, rrjedhimisht të vërtetuar në shkallën e dytë. Prandaj, kjo pjesë e ankesës shpallet e papranueshme.

### C.2. Shkeljet substanciale të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 403 të KPPK-së

#### Se shkelja substanciale e dispozitave të procedurës penale sipas nenit 403 paragrafit 1 nën-paragrafëve 8 dhe 12 të KPPK-së ka ndodhur

18. Prokurori Special pretendon se aktgjykimi i kundërshtuar përmban shkelje të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 403 paragrafit 1 nën-paragrat 12 të KPPK-së. Ai përmend se dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë nuk është përpiluar në pajtim me nenin 391 paragrin 1 të KPPK-së sepse është i pakuptueshëm sa i përket datës së saktë të ngjarjes dhe elementeve përbërëse të veprave penale. Prokurori Special pretendon se të dy gjykatat nuk kanë ofruar asnjë arsyetim mbi dashjen dhe motivin e kryerësve edhe pse ato janë cekur qartë në aktakuzë. Sipas mendimit të Prokurorit, gjykata e shkallës së dytë ka bërë shkelje të nenit 403 paragrafit 1 nën-paragrat 12 sepse Prokurori në pajtim me nenin 401 paragrin 1 të KPPK-së ka paraqitur prova plotësuese<sup>6</sup> së bashku me ankesën e tij, e cila nuk është marrë parasysh nga koleksi i Gjykatës Supreme. Prokurori i Shtetit mbështet pretendimet e Prokurorit Special në lidhje me këtë.

19. Avokati mbrojtës Tahir Rrecaj kundërshton aktgjykimin e shkallës së parë sepse dispozitivi ndryshon nga pika (a) në pikën (b), duke e bërë atë të paqartë dhe kundërthënës. Si pasojë, gjykata e shkallës së dytë gabimisht ka interpretuar dispozitat e neneve 396 paragrin 4 dhe 391 paragrin 1 të KPPK-së. Sipas mendimit të mbrojtjes, gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë parasysh dashjen dhe motivin e kryerësve si elemente esenciale të veprës penale

<sup>6</sup> Deklaratat 11 dëshmitarëve dhe aktakuza PP nr. 36/2011

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Api-Kži nr. 2/2012

24 shtator 2012

Vrasje e rëndë. Neni 147 paragrafi 1 nën-paragrafi 11 i KPK-së kërkon në mënyrë të quartë ekzistimin e dashjes dhe motivit. Gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar me saktësi provat kontradiktore dhe nuk ka ofruar gjetje të qarta lidhur me vlerësimin e tyre. Gjykata e shkallës së dytë nuk ka dhënë arsyetim lidhur me argumentet e përmendura në ankesat kundër aktgjykit të shkallës së parë. Për më tepër, mbrojtja konteston përfundimin e shkallës së dytë i cili pranon gjetjet e gjykatës së shkallës së parë lidhur me dënimin e të akuzuarve dhe peshën e deklaratave të dëshmitarit R.T. të dhëna në një tjetër lëndë (rasti i shpërthimit). Mbrojtja gjithashtu pretendon në shkelje të standardeve të të drejtave të njeriut<sup>7</sup> pasi që të dy gjykatat të cilat kanë gjykuar rastin e shpërthimit (P nr. 488/2008) dhe vrasjes së trefishtë (P nr. 459/2009) kanë pasur ide të paramenduar dhe nuk i janë përbajtur parimit të supozimit të pafajësisë.

20. Përveç këtyre pretendimeve, avokati mbrojtës i S.Q. pohon në shkelje sipas nenit 403 paragrafit 1 nën-paragrafit 8 të KPPK-së pasi që aktgjyki i shkallës së parë është bazuar në prova të papranueshme, përkatësisht në deklaratat e dëshmitarit R.T. NË përgjigjen e tij, avokati mbrojtës Mahmut Halimi për B.H. thekson se Gjykata Supreme e Kosovës, duke vepruar si shkallë e dytë nuk ka marrë parasysh provat e reja të propozuara nga mbrojtja dhe prokuroria.

21. Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se pretendimi se gjykata e shkallës së dytë ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës penale në lidhje me provat e reja të pretenduara, është i pabazuar.

22. Të ashtuquajturat “provat e reja” i referohen një versioni të ri të fakteve materiale të dhëna nga dy të pandehurit dhe të mbështetura nga dëshmitarët. Këto sqarime i janë bashkangjitur ankesës së parë të paraqitur nga Prokuroria më 30 maj 2011. Përbëhen nga deklaratat e dëshmitarëve të mbledhura në lëndën kundër N.C., A.D. dhe A.D.2 në lidhje me të njëjtin incident i cili ka ndodhur në natën në mes të 27 dhe 28 shtatorit 2007.

23. Është vërejtur që në aktgjykimin Ap-Kz nr. 264/2011, duke e marr parasysh provat e dorëzuara, Gjykata e shkallës së dytë ka theksuar që:

“43. Në këtë pikë duhet të përmendet që as mbrojtja as prokuroria nuk kanë paraqitur asnjë provë të re ... Megjithatë, edhe pse me propozimin e avokatit mbrojtës Av. Mehmet Halimi në mënyrë të quartë e kërkuar nga kryetari i kolegit në seancën ankimore, nëse prokurori dëshiron të paraqes prova të reja në gjykatë, gjithashtu edhe prokurori i ZPSH-së Juzuf Mezzini përfundimisht në mënyrë të quartë e ka mohuar. Gjithashtu ia vlen të përmendet që në kontekstin e dhënë që i është komunikuar Kryetarit të kolegit të Gjykatës Supreme jo zyrtarisht por pas seancën ankimore që i pandehuri S.Q., i cili deri më tanë e ka mbrojtur veten tërësisht në heshtje, së bashku me të pandehurin B.H. përderisa (pasi që ata janë shpallur fajtorë për vrasjet) kanë theksuar para prokurorit që ka qenë i pandehuri i liruar Nysret Qena së bashku me disa dëshmitarë që kanë qëlluar në veturën e viktimate ...”

<sup>7</sup> Neni 3 paragrafi 1 i KPK-së, neni 31 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 6.2 i KEDNj-së dhe neni 14.2 i Marrëveshjes Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike i datës 16 dhjetor 1966 (MNDCP); referencë për Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEdNj), lënda Barbera, Messegue dhe Jabardo kundrejt Spanjës, Aplikacioni nr. 10590/83, 6 dhjetor 1988

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Api-Kži nr. 2/2012

24 shtator 2012

44. Përkundër kësaj, edhe Gjykata Supreme e Kosovës nuk ka dhunti me aftësi të mendje hollësisë prandaj nuk mundet vetëm të supozoj se qfarë njëra prej palëve në gjykim do të dëshiroj të paraqes, nëse kjo përfundimisht nuk është bërë në fakt konsiderohet pothuajse e tepërt për të përmendur që në rast të provave të pretenduara të reja rihapja e serishme e procedurës kundër B.H.t dhe S.Q.t në bazë të neneve 438 deri 447 të KPPK-së do të ishte mënyra më e përshtatshme për hyrjen e serishme në procedurat gjyqësore kundër të pandehurve e posaçërisht të atyre që tashmë janë liruar në lëndën përkatëse. [...]"<sup>8</sup>

24. Formulim i mësipërm është disi i pafate dhe mund të çorientoj, në veçanti që informata i është "...komunikuar në mënyrë jozyrtare kryetarit të kolegit të Gjykatës Supreme por pas seancës ankimore ..." Nëse prova i është komunikuar në mënyrë jozyrtare kryetarit të kolegit pas seancës, kjo mund të përbëjë shkelje të dispozitave të procedurës penale. Megjithatë, formulimi vetëm ka të bëjë me informatat që tashmë i janë të njoitura palëve gjatë seancën së Gjykatës Supreme më 11 tetor 2011. Kjo informatë gjithashtu është komentuar nga prokurori i shtetit Jusuf Mezini gjatë seancën ankimore dhe nga avokatët mbrojtës të B.H.<sup>9</sup>

25. Pjetja tjetër ka të bëj me pretendimin që gjykata e shkallës së dytë në mënyrë domethënëse ka shkelur dispozitat e procedurës penale duke mos e marr parasysh këtë informatë të re. Është e qartë nga fragmentet e mësipërme të aktgjykit të Gjykatës Supreme Ap-Kz nr. 264/2011, dhe përkundër pasaktësisë së përmendur më lart, që gjykata e shkallës së dytë ka qenë e vetëdijshme për informatën e re dhe e ka marr parasysh,<sup>10</sup> edhe pse jo në mënyrë të plotë dhe të qartë. Gjykata e shkallës së dytë nuk i ka shkelur në mënyrë substanciale dispozitat e procedurës penale pasi që kjo gjykatë në fakt e ka marr parasysh 'provën e re.

26. Sa i përket pretendimeve tjera sipas nenit 403 paragrafit 1 nën-paragrafëve 8 dhe 12 të KPPK-së, Gjykata Supreme e Kosovës në tërësi pajtohet me arsyetimin e gjykatës së shkallës së dytë dhe nuk ka nevojë të përsërisë gjetjet e përpiluara në aktgjykim Ap-Kz nr. 264/2011 të datës 12 tetor 2011.<sup>11</sup> Sa i përket lënies jashtë të pretenduar të gjykatës së shkallës së parë për të përmendur qëllimin dhe motivin e kryerësve të veprës, gjykata e shkallës së tretë deklaron përsëri që ligji penal nuk përcakton që motivi është kërkësë e nevojshme në cilësimin ligjorë të veprës penale të Vrasjes së rëndë.<sup>12</sup> Kolegji i Gjykatës Supreme theksón që motivi nuk është i njëjtë sikurse qëllimi i nevojshëm (*mens rea*) i veprës penale siç theksohet në nenin 15 të KPK-së. Qëllimi, qoftë i drejtpërdrejtë ose eventual ka të bëj me njojurinë dhe/ose gatishmërinë e kryerësit të veprës të pranoj krimin (*actus rea*). Ndryshe nga kjo është motivi

<sup>8</sup> Gjykata Supreme e Kosovës, Ap-Kz nr. 264/2011, Aktgjyki i shkallës së dytë, 12 tetor 2011, faqet 18-19, paragrafët 43-44

<sup>9</sup> Gjykata Supreme e Kosovës, Ap-Kz nr. 264/2011, procesverbali i seancës ankimore, 11 tetor 2011, faqe 6

<sup>10</sup> Gjykata Supreme e Kosovës, Ap-Kz nr. 264/2011, Aktgjyki i shkallës së dytë, 12 tetor 2011, faqet 18-19, paragrafi 43: "...që i pandehuri S.Q., i cili deri më tanë e ka mbrojtur vvetven tërësish në heshtje, së bashku me të pandehurin B.H. në ndërkohë (pasi që ata janë shpallur fajtorë për vrasjet) ka theksuar para prokurorit që ka qenë pandehuri i liruar N.C. së bashku me disa dëshmitarë ata të cilët kanë shtënë në veturën e viktimate. [...]"

<sup>11</sup> Ibid, faqe 8, paragrafi 12: "Gjykata Supreme e Kosovës gjen se dobësitet e pretenduara të dispozitivit të aktgjykit të kundërshtuar nuk e arrijnë nivelin e ashpërsisë që do të arsyetonte anulimin e aktgjykit për shkak të shkeljes substanciale të procedurës penale, siç konsiderohet nga nenii 403 paragrafi 1pika 12 e KPPK-së"

<sup>12</sup> Ibid, faqe 9, paragrafi 14

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Api-Kži nr. 2/2012

24 shtator 2012

që individi mund të ketë për të kryer krimin. Kolegji i Gjykatës Supreme konsideron, në të njëjtë mënyrë sikurse e ka bërë gjykata e shkallës së dytë, që Gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë përfundon që mungesa e dëshmisë mbi motivet e pretenduara të të pandehurve.<sup>13</sup> Përfundimisht, në kundërshtim të parashtresave të mbrojtjes, ky kolegj konsideron që dispozitivi përmban minimumin e kërkësave sipas nenit 396 të KPPK-së i lidhur me nenin 391 paragrafin 1 të KPPK-së.

27. Mbi këtë sfond, Gjykata Supreme konsideron që asnjë shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale nuk është kryer as nga gjykata e shkallës së parë e as nga gjykata e shkallës së dytë.

### **Që ka ndodhur vërtetimi i gabuar dhe/ose jo i plotë i gjendjes faktike sipas nenit 405 të KPPK-së**

28. Mbrojtja dhe prokuroria pretendojnë që gjykata e shkallës së parë në mënyrë të gabuar ka bërë vërtetimin e gjendjes faktike. Prokurori i shtetit pajtohet me këto paraqitje. Palët i referohen hapjes së hetimeve përfunduese të njëjtë kundër të dyshuarve tjerë, pas seancave dëgjimore të të pandehurve B.H. dhe S.Q. si dhe të disa dëshmitarëve. Prokurori dhe avokati mbrojtës i B.H. pohojnë që gjykata e shkallës së dytë ka dështuar të analizojë argumentet e paraqitura në fazën ankimore dhe të hapjes së seancës dëgjimore përmarrjen e provave të reja. Prokurori special ofron përbledhje të këtyre informatave shtesë dhe pohon që deklaratat e dëshmitarëve të jenë të besueshme.<sup>14</sup> Avokati mbrojtës i B.H. kundërshton që gjetjet e gjykatës së shkallës së dytë që as mbrojtja e as prokuroria nuk ka paraqitur prova të reja,<sup>15</sup> edhe pse Prokurori i shtetit, gjatë seancës ankimore, e ka dorëzuar këtë provë. Ai paraqiti që gjykata e shkallës së dytë në mënyrë të gabuar ka drejtuar që hapja e serishme e procedurës kundër të pandehurve B.H. dhe S.Q. mund të bazohet në nenet 438 deri 447 të KPPK-së.

29. Palët gjithashtu kundërshtojnë vlerësimin e provave të bërë nga Gjykata e shkallës së parë, veçanërisht deklaratat e dëshmitarit R.T. të dhëna në polici dhe tek prokurori. Veç kësaj, avokati mbrojtës Tahir Rrecaj pretendon që të dyja gjykatat në mënyrë të njëanshme kanë vlerësuar deklaratat e dëshmitarëve të dhëna nga ky dëshmitarë dhe vetëm se ia kanë bashkangjitur peshën në këto prova që shkojnë në dobi të prokurorisë. Ai paraqet përbledhje të deklaratave të R.T. dhe të mospërputhjeve që përbëjnë ato, dhe pohon që gjykata e shkallës së dytë nuk ka dhëne asnjë arsyetim mbi argumentet e mbrojtjes në lidhje me këtë. Ngjashëm, gjykata e shkallës së parë nuk e ka vlerësuar në mënyrë të duhuar deklaratat e X.T. e gjithashtu

<sup>13</sup> Gjykata e Qarkut në Prishtinë, P nr. 459/2009, Aktgjyktimi i shkallës së parë, 7 shkurt 2011, faqe 30: "Kolegji vëren që, megjithatë, që mungesa e dëshmisë së plotë mbi motivet e krimit nuk është pengesë e vërtetimit të përgjegjësisë penale kundër të pandehurve, sepse pjesa tjetër e kornizës dëshmuese është e fortë dhe vendimtare."

<sup>14</sup> Më 25 maj 2011, PSRK-ja lëshoi aktvendimin PPS nr. 36/2011 përfillimin e hetimeve kundër të pandehurve N.C., A.D. dhe A.D.2 përfunduese të njëjtat fakte dhe akuza të njëjtë penale me të cilat ishin dënuar B.H. dhe S.Q.. Aktakuza është ushtruar më 7 tetor 2011 pas mbledhjes së provave e cila qëndron në deklaratat e bashkë të pandehurve B.H. dhe S.Q., dhe të disa dëshmitarëve, p.sh.: B.H., F.H., A.H., M.Q., A.H.

<sup>15</sup> Shih *inter alia* Gjykata Supreme e Kosovës, Ap-Kz nr. 264/2011, Aktgjyktimi i shkallës së dytë, 12 tetor 2011, faqet 18-19, paragrafët 43-44

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Api-Kz nr. 2/2012

24 shtator 2012

të linjës kohore të ngjarjes dhe të kushteve atmosferike në kohën e veprës penale. Përfundimisht, ai pretendon që gjykata e shkallës së parë ka arritur gjetje të gabueshme të përshkrimit faktik pasi që nuk është kryer asnjë rekonstruktim të vend ngjarjes dhe identifikimi i S.Q. është bërë në kundërshtim me nenin 255 të KPPK-së dhe nuk është i besueshëm. Përveç kësaj, avokati mbrojtës Avni Ibrahim pretendon që nuk ekzistojnë prova të drejtpërdrejta që i pandehuri S.Q. ishte përfshirë në veprën penale dhe që gjykata e shkallës së dytë ka dështuar t'i përgjigjet argumenteve të paraqitura nga mbrojtja. Në përgjigjen e tij, avokati mbrojtës Azem Vllasi dhe N.C. e kundërshtojnë pranueshmërinë dhe lidhjen e provës së re të pretenduar.

30. Gjykata Supreme e Kosovës i gjen të pa mëritë pretendimet e mbrojtjes që kanë të bëjnë me vlerësimin e gabuar të provave nga gjykata e qarkut. Ky kolegj është i mendimit që gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë i ka vlerësuar provat dhe peshën e tyre për arritjen e përfundimeve të drejta dhe lidhur me këtë pajtohet me gjykatën e shkallës së dytë. Pasi që këto paraqitje janë kopje e thjeshtë e atyre të paraqitura gjatë procedurës së ankesës së parë, kolegji i nënvizuar posaçërisht i referohet gjetjeve të shkallës së dytë në këtë pikë.<sup>16</sup>

31. Kolegji i nënvizuar, megjithatë dëshiron t'i përgjigjet pretendimit të mbrojtës lidhur me refuzimin e propozimit për të kryer rekonstruktimin e vendngjarjes. Gjykata e shkallës së parë e ka bazuar refuzimin e saj mbi bazat që “duhet të përsëritet këtu që kërkesa për rikonstruktim të vendngjarjes nuk mund të kryhet në mënyrë të suksesshme gjatë shqyrimit gjyqësor, duke qenë e pamundur të prodhoj sërisht kushte dhe ndriçim të njëjtë meteorologjik të natës kritike. Në anën tjetër, inspektimi i vendngjarjes është vërtetuar të jetë i tepërt, duke marr parasysh sasinë e madhe të dokumenteve të provave të paraqitura në shkresat e lëndës (fotografitë, fotografitë nga ajri, hartat e skicuara), të cilat gjithashtu i janë dorëzuar dëshmitarëve gjatë ekzaminimit të tyre prandaj edhe janë të mjaftueshme për ndriçimin e rastit mbi çështjet faktike dhe topografike të lidhura me këtë lëndë.”<sup>17</sup> Gjykata Supreme vëren që më 3 gusht 2010, trupi gjykuar e ka urdhëruar Institutin Meteorologjik të Kosovës të lëshojë raport përfazën e hënës, kushtet atmosferike dhe orëve të lindjes dhe perëndimit të hënës në mes të 27 dhe 28 shtatorit 2007 në regionin e Kaçanikut. Gjykata e shkallës së parë gjithashtu ka pranuar prova dokumentuese të lidhura me këtë pikë si p.sh.: tri harta ajrore me shkallë metrike të bashkangjitura në hartën e skicuar,<sup>18</sup> dhe i ka vlerësuar këto prova. Kolegji i Gjykatës Supreme konsideron që nga ajo që u tha më lart rekonstruktimi i vendngjarjes me kushte jo të ngjashme meteorologjike më tepër se tri vite pas ngjarjes do të ishte i panevojshëm.

32. Sa i përket pretendimeve të lidhura me identifikimin e S.Q.t nga dëshmitari R.T., kolegji i Gjykatës Supreme vëren që gjatë dëgjimit të tij para prokurorit më 4 mars 2009, dëshmitari ka ofruar përshkrim të personit që quhet ‘S.’<sup>19</sup>. Ai ka theksuar që pas një muaji apo

<sup>16</sup> Shih *inter alia* Gjykata Supreme e Kosovës, Ap-Kz nr. 264/2011, Aktgjyki i shkallës së dytë, 12 tetor 2011, faqe 12, paragrafët 17-18

<sup>17</sup> Shih Gjykata e Qarkut në Prishtinë, P nr. 459/2009, Aktgjyki i shkallës së parë, 7 shkurt 2011, faqet 6-7

<sup>18</sup> Ibid, faqet 5-6

<sup>19</sup> Shih, regjistrimin e dëgjimit të dëshmitarit në hetimin PNH nr 623/07 të datës 4 mars 2009, faqe 2: ai përmendi “një person po e mbante një armë të gjatë përgjatë rrugës së asfaltuar...”, “më vënë unë e kuptova që

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Api-Kži nr. 2/2012

24 shtator 2012

ashtu disi, në kafeteri në Ferizaj, ai i tha B.B. që ai e kishte parë S.Q., të pranishëm në kafeteri me një fëmijë në atë natë kritike. Pastaj atij i janë treguar fotografi dhe në mënyrë të qartë e ka identifikuar S.Q. si person që ishte mbi urë duke mbajtur armë të gjatë në natën e ngjarjes.<sup>20</sup> Sipas mendimit të Gjykatës Supreme, identifikimi është bërë në pajtim me nenin 255 të KPK-së. Kolegji i nënvizuar nuk sheh ndonjë problem nëse identifikimi i bërë nga dëshmitari është kryesisht i bazuar në kujtimin pasues të karakteristikave kryesore të të dyshuarit. Ndryshe nga mbrojtja mbështet që identifikimi është bërë në bazë të vlerësimeve të dëshmitarit R.T. e jo të B.B. dhe në pajtim me rregullat e procedurës penale.

33. Në lidhje me informatën e re, që do të thotë që këto deklarata të bashkë të pandehurve dhe të këtyre dëshmitarëve, pjesë të këtyre paraqitjeve, tashmë ishin paraqitur nga Prokurori Special në ankesën e tij të datës 26 maj 2011 siç është përmendur më lart. Përbajtja e ankesës është e njëjtë me atë të dorëzuar në fazën e shkallës së dytë. Prokurori Special përmes ankesës së tij kundër vendimit mbi dënimin e B.H. dhe S.Q., duket të sfidoj gjetjet e gjykatës lidhur me Nyrset Cenën me qëllim të prishjes së lirimit të tij.

34. Siç vërtetohet nga të dhënat e gjykatës, kryetari i kolegjit i ka dhënë rastin prokurorit të shtetit që të parashtroj propozim për hapjen e seancës dëgjimore për marrjen e provave të reja gjatë seancës së ankesës së parë në tetor të vitit 2011. Prokurori, përderisa përmendte hetimin që ende vazhdon në të njëjtën lëndë, refuzoi propozimin për të paraqitur prova të reja.<sup>21</sup> Elementet e provave të paraqitura nga prokuroria dhe të përkrahura nga mbrojtja në ankesat e tyre tashmë ishin dorëzuar gjatë seancës së ankesës së parë. Prandaj, situata në fjalë nuk e arsyeton anulimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë dhe të kthimit të lëndës në shkallën e parë.

35. Për më tepër, Gjykata Supreme vëren që nuk është e pazakonshme gjatë procedurës penale që prova e re paraqitet për të sfiduar gjetjet faktike të kryera nga gjykata e shkallës së parë duke përfshirë vlerësimet e reja të ngjarjes të dhëna nga të pandehurit. Kjo është se çfarë ka ndodhur në lëndën në fjalë pasi që i pandehuri B.H. pas aktgjykimit të shkallës së parë ka ndryshuar versionin e tij – i përkrahur nga dëshmitarët e alibisë – të fakteve vendimtare derisa i pandehuri S.Q. ka vendosur të sqaroj vet në vend të qëndrimit në heshtje siç ai e ka bërë gjatë shqyrtimit gjyqësor.

36. Kjo gjykatë do të marr parasysh në mënyrë më të plotë elementet e provave të dorëzuara nga prokurori në ankesën e tij të datës maj 2011. Deklaratat e reja duket të tregojnë

---

personi që e mbante armën quhej S.Q., ai kishte flokë të verdhë, flokët e tij ishin të rruara prapa, dhe ai kishte të veshur diçka të zezë dhe të hapur nga prapa”.

<sup>20</sup> Ibid, faqe 3

<sup>21</sup> Gjykata Supreme e Kosovës, Ap-Kz nr. 264/2011, procesverbal i seancës ankimore, i datës 11 tetor 2011, faqe 5: “*Kryetari i kolegjit: Siç kam thënë ne nuk do të vlerësojmë asnjë provë të re në këtë seancë. z. prokuror, a planifikoni të paraqitni prova të reja? prokurori: Jo, unë nuk ka prova të reja për të paraqitur.*”; shih gjithashtu faqen 6: “*prokurori: Unë vetëm dëshirova të përmend disa nga arsyet. Pasi që aktgjykimi është lëshuar, prokurori special i ka ekzaminuar një numër të dëshmitarëve lidhur me këtë lëndë dhe ka lëshuar aktvendim mbi fillimin e hetimeve kundër N.C, A.D. dhe A.D.2. Këto hetime janë ende duke u zhvilluar. Pasi që kjo është në lidhje me vrasjen dhe tentim vrasjen e njëjtë, prokurori special në ankesën e tij propozoi bashkimin e dy lëndëve dhe që të mbahet shqyrtimi gjyqësorë. Kështu, unë propozoj që të pranohet ankesa e prokurorisë në tërësi dhe që lënda të kthehet në rigjykim. Ne i përkrahim paraqitjet tona me shkrim. Faleminderit.*”

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Api-Kz nr. 2/2012

24 shtator 2012

që N.C. është figurë dominonte pas sulmit mbi urën e Lepencit në natën në mes të 27 dhe 28 shtatorit 2007 dhe ka marr pjesë si një nga dy personat që kanë shtënë në viktimat. Për më tepër, deklaratat e reja duken deri në një shkallë substanciale të jenë rezultat i bisedimeve në mes të dëshmitarëve të ndryshëm dhe të bashkë të pandehurve që ka ndodhur pas ngjarjeve. Shumica e dëshmitarëve të rinj të paraqitur janë ose anëtarë të familjes së B.H. dhe S.Q. ose të shokëve të tyre. Deklaratat e dëshmitarëve të rinj të paraqitur jasin vlerësimë të ndryshme të ngjarjeve se sa ajo që kolegji i gjykatës së qarkut e ka vërtetuar.

37. Versioni i ri i ngjarjeve i dhënë nga i pandehuri B.H. ishte qartë në dispozicion në kohën e shqyrtimit gjyqësorë, megjithatë i pandehuri pastaj vendosi të jep vlerësim tjetër. Versioni tani i theksuar nga i pandehuri S.Q. ishte gjithashtu në dispozicion të tij gjatë shqyrtimit gjyqësor, por ai vendosi që të qëndroj në heshtje. Asnjë nga të pandehurit nuk ka vendosur të jep këtë vlerësim të rrij të fakteve gjatë shqyrtimit gjyqësor edhe pse ishte në dispozicion për të dytë në të njëjtën kohë. Në vend të kësaj, i pandehuri B.H. iu drejtua dëshmitarëve të tjerë të përkrahin versionin e tij të parë, prandaj edhe do ti bartë pasojat e kësaj zgjedhjeje.

38. Duke e marr parasysh informatat e reja, Gjykata Supreme *inter alia* do të vlerësoj që nëse prova të reja do të ishin paraqitur në shqyrtimin gjyqësorë, do të mund të kishte ndikim në aktgjykimin e shkallës së parë dhe që përjashtimi i tij do të sjellë tek dështimi i drejtësisë. Është mendimi i kolegit të Gjykatës Supreme që informatat e reja nuk do të kishin ndikim në aktgjykimin e shkallës së parë përsye të asaj që u deklarua dhe u tha më lart.

39. Sa i përket besueshmërisë së dëshmitarëve që kanë dëshmuan në shqyrtimin gjyqësorë, kolegji i Gjykatës Supreme i referohet jurisprudencës së Gjykatës Supreme të Kosovës në lëndën R. et al.: “procedurat ankimore në KPPK qëndrojnë në parimet që për gjykatën e shkallës së parë është të dëgjoj, vlerësoj dhe të peshoj provat në gjykim ... Prandaj, gjykata e apelit nevojitet që ti jap gjykatës së shkallës së parë vlerësim të lirë në arritjen e gjetjeve faktike.”<sup>22</sup> Ngjashëm, në lëndën e V.U. et al., Gjykata Supreme konstatoi që “Gjykata Supreme e Kosovës duhet ti referoj vlerësimit nga trupi gjykues të besueshmërisë së dëshmitarëve që paraqiten personalisht para tyre dhe të cilët kanë dëshmuan personalisht para tyre. Nuk është e përshtatshme për Gjykatën Supreme e Kosovës të anashkalohet vlerësimi i besueshmërisë së trupit gjykues të atyre dëshmitarëve vetëm nëse ekzistojnë arsyet e fortë për ta bërë atë ...”<sup>23</sup>

40. Duke i referuar vlerësimit të ri të fakteve qefte nga dy të pandehurit ose nga dëshmitarët e rinj nuk është në vete ‘bazë e fortë për të refuzuar trupin gjykues. Kolegji i Gjykatës Supreme duhet gjithashtu të vlerësoj arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me përcaktimin e gjendjes faktike. Roli i B.H. dhe S.Q. është theksuar qartë në aktgjykimin e shkallës së parë.<sup>24</sup> Ky arsyetim është gjithëpërfshirës, i hollësishëm, logjik dhe koherent. Për më tepër, trupi gjykues në mënyrë të plotë ka ekzaminuar alibitë duke përfshirë dëshmitarët e

<sup>22</sup> Gjykata Supreme e Kosovës, Ap-Kz nr. 477/05, lënda R. et al., aktgjyki i shkallës së dytë, 25 janar 2008, faqe 20

<sup>23</sup> Gjykata Supreme e Kosovës, Ap-Kz nr. 478/2005, lënda S. et al., aktgjyki i ankimuar, 28 maj 2007, faqe 24

<sup>24</sup> Gjykata e Qarkut në Prishtinë, P nr. 459/2009, aktgjyki i shkallës së parë, 7 shkurt 2011, faqet 10-33

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
**Api-Kži nr. 2/2012**  
**24 shtator 2012**

alibisë, e pastaj e paraqitur nga mbrojtja. Gjithashtu, Gjykata e Qarkut ka siguruar vlerësim të hollësishëm të deklaratave të ndryshme të dhëna nga dëshmitari kyç R.T. mbi identifikimin e S.Q.t si një nga dy personat mbi urë,<sup>25</sup> përfshirë *inter alia* mundësinë e identifikimit të gabuar.

42. Kundër këtij sfondi dhe posaçërisht duke marr parasysh informatat e reja të paraqitura nga prokurori i shtetit në ankesën e parashtuar më 30 maj 2011, kolegji i Gjykatës Supreme gjen se asnjë element i paraqitur qoftë nga avokatët mbrojtës apo prokuroria nuk rrezikon seriozisht saktësinë apo besueshmërinë e fakteve materiale siç përcaktohet nga Gjykata e Qarkut. Kështu që, nuk ekziston vërtetim i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike në nivelin e shkallës së parë. Kështu që baza e ankesës refuzohet si jo meritore.

Që shkelja e ligjit penal është kryer sipas nenit 404 paragrafit 1 nën-paragrafit 1 të KPPK-së dhe që vendimi mbi sanksionet penale është i gabuar sipas nenit 406 të KPPK-së

43. Avokati mbrojtës Tahir Rrecaj pretendon shkelje të ligjit penal sipas nenit 404 paragrafit 1 nën-paragrafit 1 të KPPK-së i lidhur me nenin 147 paragrin 1 nën-paragrin 3 dhe 11, neni 20 dhe 23 dhe neni 328 parografi 2 të KPK-së. Nga këndvështrimi i tij, gjykata e shkallës së parë në mënyrë të gabuar ka aplikuar cilësimin juridik sipas nenit 147 paragrafit 1 nën-paragrafit 3 të KPK-së pasi që nuk ekzistojnë prova që vërtetojnë që të pandehurit kanë vepruar në mënyrë mizore ose mashtruese. Ai paraqet shpjegimet mbi veprën e vrasjes të kryer në mënyrë mashtruese e cila lë të kuptohet që kryerësi i veprës aktualisht e mashtron dhe zë në pritë viktimin. Avokati mbrojtës Avni Ibrahim pretendon që duke marr parasysh shkeljet e procedurës penale dhe të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, të dy gjykatat kanë shkelur ligjin penal në dëm të të pandehurit S.Q. sipas nenit 404 paragrafit 1 nën-paragrafit 1 të KPPK-së.

44. Gjykata Supreme e Kosovës pajtohet me gjetjet e shkallës së parë dhe të dytë lidhur me këtë dhe për këtë qëllim i referohet aktgjykimit të Gjykatës Supreme Ap-Kz nr. 264/2011. Këto arsyet gjithashtu janë refuzuar si të pa mëritë.

45. Është vendosur si në dispozitiv.

## Kryetar i kolegjitet

## Anëtare e kolegjit

<sup>25</sup> Ibid, *fāqīt* 10-24

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
**Api-Kži nr. 2/2012**  
**24 shtator 2012**

---

Tore Thomassen, Gjyqtar i EULEX-it

**Anëtare e kolegjit**

---

Elka Filcheva-Ermenkova,  
Gjyqtare e EULEX-it

**Anëtare e kolegjit**

---

Cornelia Peeck, Gjyqtare e EULEX-it

---

Nesrin Lushta, Gjyqtare e Gjykatës Supreme

**Anëtar i kolegjit**

---

Avdi Dinaj, Gjyqtar i Gjykatës Supreme

**Procesmbajtëse**

---

Chiara Rojek, Zyrtare Ligjore

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
**Api-Kži nr. 2/2012**  
**24 shtator 2012**  
**Prishtinë**